



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Maj 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Maj 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin maj të vitit 2023)

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së aprovoi Raportin financiar për periudhën janar-mars 2023

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës mbajti takimin e radhës, në të cilin përveç anëtarëve, mori pjesë edhe Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së dhe udhëheqëset e njësive për buxhet dhe financa.



Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i Raportit financiar për tremujorin e parë të vitit 2023. Me këtë rast, Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, prezantoi raportin financiar për të gjitha kategoritë ekonomike në të gjitha programet buxhetore, raport ky, i cili u miratua më pas nga anëtarët e këtij komisioni.

Gjithashtu, ky komision shqyrtoi edhe kërkesën e Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës për rritje prej 100% të tarifave për avokatë dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ të KPK-së për shkak të tarifave të vogla, kërkesë kjo, e cila pas shqyrtimit të ndikimit financiar dhe mundësive buxhetore do të dërgohet për shqyrtim me arsyetime dhe sqarime në njërin nga takimet e KPK-së.

Diskutohet drafti i Rregullores për Qasje në Dokumente Publike

Grupi punues për hartimin e Rregullores për Qasje në Dokumente Publike, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij grupi nga radhët e sistemit prokurorial dhe përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë, ka mbajtur takimin e parë për shqyrtimin e draftit të kësaj rregulloreje.



Me këtë rast, anëtarët e Grupit punues dhe përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë, theksuan ky draft do të lehtësojë në masë të konsiderueshme realizimin e procedurave për parashtresit e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe për institucionet e sistemit prokurorial që ofrojnë një qasje të tillë.

Ky grup punues do të vazhdojë punën në ditët në vijim deri në finalizimin e plotë të tij, në mënyrë që të kemi një draft të kompletuar bazuar në ligjet përkatëse që rregullojnë këtë fushë.

Mbahet takimi i parë i Grupit punues për vlerësimin e sistemit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Në kuadër të aktiviteteve që dalin nga Deklarata e përbashkët e zotimit për reformën ligjore në sistemin e drejtësisë në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, Grupi punues për vlerësimin e sistemit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka mbajtur takimin e parë, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij grupi dhe partnerët ndërkombëtarë.



Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për orientimin e veprimeve të cilat do të ndërmerren në të ardhmen nga ana e këtij grupi punues.

Rrjedhimisht, pjesëmarrësit janë pajtuar për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe në këtë kontekst, kanë theksuar se ky grup punues do të takohet përsëri pas pranimit të raporteve të vlerësimit nga ana e përfaqësuesve ndërkombëtarë, për të avancuar më tutje këtë proces të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka mbajtur takimin e radhës, me ç'rast është diskutuar për procesin e rregullt të monitorimit të zbatimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në punën e prokurorive të vendit.



Gjatë këtij takimi është bërë prezantimi i krahasimit të raporteve manuale të prokurorive themelore dhe është diskutuar për fuqizimin e përdorimit të SMIL-it në kuadër të stafit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe për ngritjen e cilësisë së të dhënave të reja në SMIL.

Gjithashtu, Komisioni diskutoi edhe për definimin e raporteve statistikore që hartohen për punën e

prokurorive dhe të prokurorëve në sistemin prokurorial dhe për intensifikimin e bashkëpunimit me ekspertët ndërkombëtarë.

Në përfundim të takimit, anëtarët e Komisionit, theksuan se synim i tyre mbetet që këto raporte të shënojnë ngritje të cilësisë së të dhënave dhe të ndikojnë në ngritjen e efikasitetit dhe transparencës në punën e prokurorive.

Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike viziton Prokurorinë Themelore në Pejë

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, ka vizituar Prokurorinë Themelore të Pejë, ku janë pritur nga Zëvendëskryeprokurori i kësaj prokurorie.



Qëllimi i vizitës në Prokurorinë Themelore të Pejë ishte shqyrtimi i Raportit tremujor për periudhën janar-mars 2023 dhe diskutimi për sfidat e trajtimit të lëndëve të korrupsionit dhe të krimeve ekonomike që hyjnë në kuadër të kësaj prokurorie.

Gjatë takimit janë vlerësuar rezultatet e arritura deri me tash dhe është diskutuar për procesin e kryerjes së lëndëve të korrupsionit dhe të krimeve ekonomike, duke kërkuar përkushtim të mëtutjeshëm për trajtimin e këtyre lëndëve që i përkasin vitit 2022 edhe 2023.

Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike është duke realizuar vizita nëpër të gjitha prokuroritë e vendit në kuadër të monitorimit aktiv të zbatimit të Strategjisë së sistemit prokurorial (2022-2024) dhe Planit të Veprimit.

Mbahet Takimi i 230-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, mbajti Takimin e 230-të me radhë, sipas rendit të paraparë të ditës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës filloi takimin e sotëm me prezantimin e raporteve të kryeprokurorëve të prokurorive të vendit për periudhën janar-mars 2023, raporte këto, që u aprovuan nga anëtarët e KPK-së.



Më pas, KPK-ja mori vendim për shpalljen e konkursit për pozitën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, nga data 1 qershor 2023, me ç'rast themeloi Panelin Vlerësues dhe Komisionin për Rishqyrtim, si dhe vendosi për hapjen e shpalljes së brendshme për avancimin e dy (2) prokurorëve në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK).

Anëtarët e Këshillit Prokurorial miratuan edhe raportin e Komisionit për avancimin e pesë (5) prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe aprovuan kërkesën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës për transferimin e përkohshëm të dy (2) prokurorëve nga Prokuroria Themelore e Ferizajt, si dhe morën vendim për hapjen e shpalljes së brendshme për transferimin e përhershëm të dy prokurorëve në këtë prokurori.

Gjithashtu, Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi dy raporte të Komisionit të Vlerësimit të Performancës për gjashtëmbëdhjetë (16) prokurorë me mandat të përhershëm dhe aprovoi një marrëveshje vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Mbahet punëtori për finalizimin e draftit të Rregullores për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Prokuroriale dhe draftit të Rregullores për Qasje në Dokumente Publike

KPK-ja ka organizuar një punëtori për prezantimin, diskutimin dhe finalizimin e draftit të Rregullores për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Prokuroriale dhe draftit të Rregullores për Qasje në Dokumente Publike.



Ne këtë punëtori morën pjesë Kryesuesi i KPK-së, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Zëvendëskryesuesi i KPK-së, Kryeprokurori i PSRK-së, kryeprokurorë të prokurorive të vendit, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, anëtarë të trupave të KPK-së, përfaqësuesja e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë dhe udhëheqës të administratës së sistemit prokurorial të Kosovës.

Në kuadër të sesionit të parë të kësaj punëtorie është paraparë prezantimi dhe diskutimi i draftit të Rregullores për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Prokuroriale, me ç'rast në fillim të punëtorisë u tha se një theks i veçantë do t'u vihet qëllimeve, fushëveprimit, parimeve dhe kompetencave të Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Prokuroriale, si dhe kërkesës për dhënien e opinioneve dhe opinionëve me vetiniciativë në aspektin e funksionimit sa më të mirë të etikës prokuroriale, komitet ky, i cili do të ndikojë në fuqizimin e mbështetjes këshillëdhënëse për etikën në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Në fokus të sesionit të dytë do të jetë shqyrtimi i draftit të Rregullores për Qasje në Dokumente Zyrtare i cili ka të bëjë me qasjen në dokumentet publike të sistemit prokurorial të Kosovës, format e qasjes, trajtimin e kërkesave për qasje, klasifikimin dhe të drejtën për ripërdorim të tyre, ndërsa sesioni i tretë do të përmbyllet me finalizimin e dy drafteve të këtyre rregulloreve.